

Ekonomia Shqiptare, ç'ka qënë, ç'është dhe ç'duhet të jetë!



RAPORT MONITORIMI

Qershor 2024

QENDRESA QYTETARE

NED INSTITUTI
NACIONAL PËR EKONOMI
DHE STATISTIKË

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
ILIR BRASHA

Përmbajtja

Hyrje:	3
Kontributi në PBB sipas Sektorëve Ekonomikë	3
Kontributi në PBB sipas Sektorëve Ekonomikë, Agrikultura, Pyjet dhe Peshkimi	4
Kontributi në PBB sipas Sektorit të Industrisë	6
Kontributi në PBB sipas Sektorëve Ekonomikë, Shërbimet	7
Turizmi dhe Ndërtimi dy sektorët që po mbajnë gjallë ekonominë shqiptare	9
Pagat sipas aktiviteteve ekonomike	11
Nënspektori i Turizmit, Kontributi në PBB dhe ndikimi i tij në ekonomi	11
Përfundime:	14
Rekomandime:	15
Referenca	16

Hyrje

Ekonomia është një nga aspektet më të rëndësishme për një shtet që tregon se sa mirë qytetarët e tij po jetojnë. Shqipëria është një nga vendet me demokraci në tranzicion drejt zhvillimit ekonomik që nga vitet '90-të. Tre janë sektorët kryesorë të ekonomisë, Agrikultura, Pyjet dhe Peshkimi; Industria dhe Shërbimet. Në botën post-industriale ka marrë vëmendje të theksuar sektori i shërbimeve. Edhe për Shqipërinë si tek pjesa më e madhe e vendeve të botës, sektori i tretë përbën sektorin me ndikimin më të madh në ekonomi, por duke pasur një pjesë të vogël të popullsisë të angazhuar në këtë sektor. Duke shikuar pjesën e punësuar në secilin nga sektorët dhe kontributin në PBB, është gjetur eficensa e secilit nga sektorët. Në këtë mënyrë është analizuar se cili sektor duhet të ketë vëmendje të shtuar nga Qeveria dhe çfarë mund të bëhet për ta përmirësuar atë.

Qëllimi i këtij punimi është që të analizojë tre sektorët ekonomikë kryesorë dhe të shikojë se cili është ndikimi i secilit prej tyre në ekonominë shqiptare duke realizuar edhe një krahasim me vendet e tjera të botës të ndara në katër kategori të ndryshme (vende me të ardhura të ulëta, vende me të ardhura të mesme të ulëta, me të ardhura të mesme të larta, dhe me të ardhura të larta). Po ashtu në raport është treguar edhe niveli i punësimit sipas secilit sektor duke bërë të mundur kështu që të shikojmë edhe raportin e kontributit në PBB të secilit sektor në ekonomi. Në shqyrtim janë përfshirë edhe dy nënsektorët më të rëndësishëm për ekonominë shqiptare në vitet e fundit siç janë Ndërtimi dhe Turizmi, duke treguar varësinë e lartë që ekonomia po krijon për shkak të këtyre dy nënsektorëve. Në fund janë dhënë edhe përfundimet bashkë me rekomandimet përkatëse.


Kontributi në PBB sipas Sektorëve Ekonomikë

Për të shikuar se ku është fokusuar ekonomia shqiptare sipas sektorëve, kemi shikuar përqindjen që zënë tre sektorët kryesorë në ekonomi për

Shqipërinë dhe mesataren për vendet e tjera të klasifikuara në vende me të ardhura të ulëta, të mesme të ulëta, të mesme të larta dhe të ardhura të larta.

Ekonomia shqiptare siç vërehet edhe në grafikun.1, ka një varësi nga sektori i Agrikulturës, Pyjeve dhe Peshkimit, që zënë 18.6% të PBB-së. Kur shikojmë pjesën që zë ky sektor në ekonomitë e vendeve të tjera mund të vërehet që ky sektor është i rëndësishëm vetëm për vendet me të ardhura të ulëta, përkatësisht 27.8%, kurse për vendet me të ardhura të larta është vetëm 2.4%. Diferenca e madhe në rëndësinë që ka sektori i Agrikulturës, Pyjeve dhe Peshkimit në ekonomine shqiptare me mesataren e vendeve me të ardhura të larta, tregon një problematikë për ekonominë shqiptare, duke qenë se një pjesë e mirë e energjisë së forcës së punës është e fokusuar pikërisht në këtë sektor dhe jo në sektor të tjerë që mund të sjellin një zhvillim më të madh ekonomik.

Grafiku 1: Kontributi i tre sektorëve kryesorë në ekonominë shqiptare, krahasuar me mesataren e vendeve të tjera sipas klasifikimit ekonomik të Bankës Botërore.




Burimi: (Banka Botërore), përpunimi i autorit¹

¹ <https://data.worldbank.org/>

Kontributi në PBB sipas Sektorëve Ekonomikë, Agrikultura, Pyjet dhe Peshkimi

Për më tepër kur shikojmë forcën punëtore të angazhuar në sektorin e Agrikulturës, Pylltarisë dhe Peshkimit rezulton që 34.93% e forcës totale punëtore në Shqipëri është e angazhuar në këtë sektor (për vitin 2022). Rezulton që produktiviteti i forcës punëtore është shumë i ulët në këtë sektor dhe përkatësisht në këtë sektor që prodhon 18.6% të PBB-së, angazhohen 34.93% e popullsisë, që nënkupton që angazhimi i 1% të popullsisë përkthehet në kontribut për PBB-në vetëm në 0.53%. Kjo vjen si pasojë, që në këtë sektor teknologjia akoma nuk është e avancuar dhe vazhdon problemi i prodhimit për konsum familjar dhe jo për të përballuar nevojat e tregut. Krahasuar me vendet e tjera pjesëmarrja e Forcës Punëtore në këtë sektor është shumë e lartë. Përkatësisht, vetëm mesatarja e vendeve me të ardhura të ulëta ka një pjesëmarrje më të lartë të forcës punëtore në këtë sektor (54.59% vs 34.93%). Në vendet me të ardhura të larta vetëm 3.62% e popullsisë është e punësuar në Agrikulturë, Pylltari dhe Peshkim, një diferencë kjo shumë e madhe krahasuar me Shqipërinë dhe vendet e tjera. Krahasuar me grupin ku Shqipëria bën pjesë, (klasifikim sipas Bankës Botërore), vendet me të ardhura të mesme të larta, Shqipëria ka një diferencë prej 15.58 pikë përqindje (34.93% Shqipëria vs 19.35% mesatarja e Vendeve me të Ardhura të Mesme të Larta).

Grafiku 2: Pjesëmarrja e Forcës Punëtore në Sektorin e Agrikulturës, Pylltarisë dhe Peshkimit, dhe Kontributi i tij në PBB




Burimi: (Banka Botërore), Përpunimi i autorit.²

² <https://data.worldbank.org/>

Kontributi në PBB sipas Sektorit të Industrisë

Në rastin kur analizojmë sektorin e Industrisë siç vërehet nga grafiku nr.3 rezulton që 21.4% e PBB-së është kontribut nga sektori i Industrisë ku përfshihet po ashtu 21.4% e Forcës Punonjëse. Kjo tregon që kontributi në këtë rast është 1 me 1, pra 1% e Forcës Punëtore kontribuon në 1% të PBB-së. Nëse shikojmë këtë raport krahasuar me rastin e sektorit të Agrikulturës, Pylltarisë dhe Peshkimit mund të duket më i mirë, por ajo çfarë tregohet kur analizohen vendet e tjera është krejt e kundërta. Kontributi i sektorit lë për të dëshiruar kur krahasohet me të gjitha vendet e tjera, qoftë edhe ato me të ardhura të ulëta. Përkatësisht, duke e quajtur koeficient të kontributit të 1% të forcës punëtore në PBB, rezulton që 1% e kontributit në PBB nga ky sektor vjen nga vetëm 0.5% e forcës punëtore në vendet me të ardhura të ulëta (kjo vjen për shkak të pagave më të ulëta dhe kompanitë e mëdha vendosin që të zhvillojnë teknologji dhe të zhvendosen në prodhim në vende me kosto më të ulëta), nga 0.67% për vendet me të ardhura të mesme të ulëta, nga 0.75% për vendet me të ardhura të mesme të larta dhe 0.81% për vendet me të ardhura të larta, kurse për Shqipërinë nga 1%. Kjo mund të jetë shkaktuar si pasojë e shtrenjtimit të forcës punëtore në Shqipëri, ku kompanitë e mëdha po investojnë në vende të tjera, ku kostot e prodhimit janë më të ulëta dhe ku nuk shfaqet problemi i mungesës së forcës punëtore. Për shkak të investimeve të ulëta në teknologji dhe faktorëve të tjerë kontributi i Sektorit të Industrisë, duke konsideruar pjesën e punonjësve që punojnë për zhvillim të këtij sektori është relativisht i ulët për Shqipërinë në krahasim me të gjitha vendet e tjera. Raporti i kontributit në PBB nga 1% e pjesës së Forcës Punëtore mund të jetë edhe më i lartë për shkak të nivelit të lartë të informalitetit që ka pikërisht sektori i Ndërtimit.

Grafiku 3: Pjesëmarrja e Forcës Punëtore në Sektorin e Industrisë (duke përfshirë edhe Ndërtimin) dhe Kontributi i tij në PBB



Burimi: (Banka Botërore), Përpunimi i autorit.³


Kontributi në PBB sipas Sektorëve Ekonomikë, Shërbimet

Kur shikojmë sektorin që jep kontributin më të lartë në Prodhimin e Brendshëm Bruto në kohët moderne, Sektorin e Shërbimeve, rezulton që Shqipëria ka një nivel më të ulët të këtij sektori që kontribuon në PBB, krahasuar me vendet me të ardhura të larta dhe të ardhura të mesme të larta. Përkatësisht, kontributi i sektorit të shërbimeve në ekonominë shqiptare është në nivelin 47.35%. Ndërkohë, tek vendet me të ardhura të larta sektori i shërbimeve është përgjegjës për 62.37% të PBB-së dhe për vendet me të ardhura të mesme të larta është në nivelin 58.81% të PBB-së. Krahasuar me vendet me të ardhura më të ulëta se Shqipëria, kontributi i sektorit të Shërbimeve në PBB të Shqipërisë është më i lartë. Kur shqyrtohet pjesa e forcës së punës së angazhuar në këtë sektor rezulton që në Shqipëri 43.67% e saj është e angazhuar në këtë sektor, krahasuar me 74.25% për vendet me të ardhura të larta, 58.81% për vendet me të ardhura të mesme të larta, 47.97% për vendet me të ardhura të mesme të ulëta, dhe 34.32% për vendet me të ardhura të ulëta. Rezultat pozitiv për Shqipërinë është që angazhimi i 1% të forcës punëtore në sektorin e shërbimeve përkthehet në më shumë se 1%

³ <https://data.worldbank.org/>

kontribut në ekonominë shqiptare. Kjo tregon që ky sektor ka vend për përmirësim dhe zhvillim të mëtejshëm. Rezultatet e tre sektorëve tregojnë që potenciali për zhvillim është pikërisht në sektorin e shërbimeve, ku edhe një pjesë më e vogël e forcës punëtore është angazhuar në këtë sektor krahasuar me vendet që ne synojmë që të arrijmë dhe gjithashtu edhe kontributi i këtij sektori në PBB nuk është në nivelin e këryre vendeve.

Grafiku 4: Pjesëmarrja e Forcës Punëtore në Sektorin e Shërbimeve dhe Kontributi i tij në PBB, 2022



Burimi: (Banka Botërore), Përpunimi i autorit.⁴

⁴ <https://data.worldbank.org/>

Turizmi dhe Ndërtimi dy sektorët që po mbajnë gjallë ekonominë shqiptare


Ecuria ekonomike e viteve të fundit tregon që rritja ekonomike është e varur nga zhvillimi i turizmit dhe ndërtimi. Ndërtimi është një nga sektorët i cili ka pasur ndikimin më të madh në rritjen ekonomike të viteve të fundit. Përkatësisht, për katërmujorin e katërt të vitit 2023, 1.28% e rritjes reale ekonomike ka ardhur pikërisht nga ky sektor. Rritja ekonomike, nëse sektori i ndërtimit nuk do ndikonte, do të ishte në masën 2.52% dhe jo 3.8% sa rezultonte. Nga ana tjetër edhe vetë aktivitetet e pasurive të paluajtshme (Real Estate) kanë një kontribut të rëndësishëm në rritjen ekonomike të vitit të fundit. Përkatësisht, në tremujorin e katërt të vitit 2023, 0.58% e rritjes vinte për shkak të këtij aktiviteti. Nëse edhe ky aktivitet do të hiqej, rritja ekonomike do të rezultonte vetëm 1.96%.

INSTAT ka përlogaritur Kontributin sipas degëve në vlerësimin gjysëm final për vitin 2021, në vitin 2023.

- Duke qenë se kontributi i Ndërtimit rezulton shumë i rëndësishëm në periudhë afatshkurtër, kemi parë se cilat bashki kanë një varësi më të lartë nga taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. Kjo vjen si pasojë, sepse pas një bumi ndërtimesh pritet një rënie e këtyre të fundit, duke shkaktuar kështu një ndikim negativ në ekonominë totale të shtetit, por gjithashtu edhe duke prekur disa bashki më shumë se të tjerat.

Përkatësisht, Bashkia me ndikimin më të madh nga taksa e ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e reja në vitin 2022 është Bashkia Himarë, e cila 56.7% të të ardhurave totale të veta që mbledh i ka pikërisht nga kjo taksë. Në radhë vazhdojnë Bashkia Kamëz me 48.4%, Bashkia Tiranë me 42.6%. Të gjitha këto bashki, në rast të frenimit të ndërtimeve të reja, do të pësojnë një reduktim në të ardhurat lokale të mbledhura e për pasojë kjo nënkupton më pak investime dhe më pak buxhet për të administruar.

Grafiku 5: Bashki me varësi më të lartë nga taksa e Infrastrukturës në Ndërtim, me më shumë se 20% të të ardhurave të tyre të veta



Burimi: (Financat Vendore), Përpunimi i autorit.⁵

Lejet e ndërtimit kanë qënë një çështje e nxehtë në skenën politike shqiptare gjatë periudhave të ndryshme. Në 10 vitet e fundit vetëm për banim, rezidencë janë dhënë leje ndërtimi 10,472 mijë metra katrorë. Nëse llogarisim se një shtëpi mesatare banimi është 90m² dhe gjithashtu se një familje mesatare ka 3.2 persona, atëherë rezulton që në 10 vitet e fundit të jenë ndërtuar banesa për rreth 372 000 banorë. Popullsia gjithnjë e në ulje e Shqipërisë, vërtetuar tanimë edhe sipas rezultateve të Censit të vitit 2023 dhe nga ana tjetër ndërtimet në masë të madhe, tregojnë që në një moment të caktuar mundësia është që të vijë një reduktim i ndërtesave rezidenciale. Duke pasur një rënie të nevojës për ndërtesa, kontributi i ndërtimit në rritjen ekonomike mund të jetë edhe negativ duke sjellë një normë më të ulët rritjeje ekonomike. Gjithashtu, ulja e ndërtimeve përveçse do të prekë ekonominë si një e tërë, do të prekë po ashtu edhe autonominë financiare të bashkive me varësi të lartë nga taksat që vijnë nga ndërtimi.

⁵ <http://financatvendore.al/data/revenues>

Pagat sipas aktiviteteve ekonomike

Një e dhënë tjetër e rëndësishme për të shikuar se cilët sektorë, po mbajnë ekonominë është edhe paga sipas secilit aktivitet ekonomik. Nëse shikohet paga sipas aktivitetit ekonomik, vërehet se paga më e lartë është në aktivitetet e organizatave ndërkombëtare, ndërsa pas saj vijnë aktivitetet e shërbimit siç janë "Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit", "Aktivitetet e Informacionit dhe Komunikimit". Vlen për t'u theksuar, se aktivitete të cilat mbajnë gjallë ekonominë shqiptare siç është ndërtimi shfaq pagë mesatare më të ulët sesa mesatarja e pagës në vend. Po ashtu aktiviteti i Agrikulturës, Pyjeve dhe Peshkimit, ku punësohet një e treta e popullsisë, është aktiviteti i dytë nga fundi me pagën më të ulët. Edhe sektori i shërbimit, duke u ndalur vetëm tek Turizmi, Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit kanë pagën më të ulët krahasuar me të gjitha pagat e tjera. Pra, shteti shqiptar, deri më tani po mbahet nga sektorë, të cilët punësojnë pjesën më të madhe të individëve, por që paga e tyre është me e ulët në krahasim me aktivitetet e tjera. Pagat e ulëta në sektorin e Turizmit nuk janë realitet vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera të Botës siç është konfirmuar në studimet e (Chia-Lin Chang & Thanchanok Khamkaew & Michael McAleer) ⁶ dhe në (Joaquim Ramos Silva & Carla Regina Ferreira Freire Guimarães) ⁷.

Nësektori i Turizmit, Kontributi në PBB dhe ndikimi i tij në ekonomi

Shqipëria është një nga vendet me rritjen më të madhe të numrit të turistëve në dy vitet e fundit. Statistikat e INSTAT tregojnë gjithashtu se po rriten netë-qëndrimet dhe mesatarja e shpenzimeve për turistë. Përsëri siç tregohet në raporte të ndryshme problem për turizmin shqiptar ngelet që turistët preferojnë të qëndrojnë për një kohë të shkurtër dhe të shpenzojnë mesatarisht pak nga të ardhurat e tyre,

⁶ <https://repub.eur.nl/pub/17310/EI2009-40.pdf> , Fq. 11.

⁷ <https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1080/23322039.2017.1319606> , fq 14

problem i cili vjen kryesisht nga mosdiversifikimi i turizmit.⁸ (Banka Botërore). Turizmi është një nga sektorët prioritar për ekonominë shqiptare dhe ka potencial të lartë për zhvillim, por duhet pasur kujdes nga varësia ndaj tij, duke mos lënë nga mbrapa sektorët e tjerë të ekonomisë që sjellin vlerë të shtuar më të lartë. Në vitin 2022, Turizmi në Ekonominë Shqiptare kontribuonte sipas Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit për 17.4% të PBB-së, ndërkohë që për vitin 2019⁹ (viti para pandemisë globale), kontributi në PBB ishte 20.3% e PBB-së (WTTC). I njëjti raport për vendet e Europës është 9.2%. Pra kontributi mesatar në PBB për vendet e Europës është 9.2%. Për vitin 2021, Shqipëria renditet si vendi i 14-të në botë për nivelin më të lartë të kontributit të Turizmit në PBB, duke pasur në renditje më të lartë vetëm Malin e Zi në Europë. Pothuajse të gjitha vendet e tjera më lart se Shqipëria janë ishuj të cilët kanë një varësi të theksuar nga Turizmi.¹⁰ (WTTC).

Efektet e Turizmit në Ekonomi, përgjithësisht shikohen pozitive, por varen nga një sërë faktorësh. Studime të ndryshme të realizuara vërtetojnë ndikim të ndryshëm të rritjes së të ardhurave të turizmit në rritjen ekonomike. Studime të (Selimi, Nasir; Sadiku, Luljeta; Sadiku, Murat)¹¹ dhe (Jonel Kristo)¹² vërtetojnë se ndikimi i rritjes së numrit të turistëve është pozitiv në ekonomi, përkatësisht studimi i parë për vendet e Ballkanit dhe i dyti specifikisht për Shqipërinë. Ndërkohë, studime të tjera tregojnë se ka një lidhje të ndikimit të turizmit në ekonomi, por deri në një stad të caktuar. Përgjithësisht, turizmi ka ndikim në rritjen ekonomike tek vendet me të ardhura të ulëta, por për vendet me të ardhura të larta nuk shikohet një ndikim i rëndësishëm.¹³ (Eugenio-Martín, Juan Luis; Morales, Noelia Martín; Scarpa, Riccardo). Për vendet e Ballkanit në përgjithësi ka pasur edhe studime të cilat kanë treguar që turizmi nuk është faktor që ndikon drejtëpërsëdrejti në rritjen

⁸ <https://blogs.worldbank.org/en/europeandcentralasia/tourism-20-albania-new-opportunity-resilient-growth>

⁹ https://wttc.org/DesktopModules/MVC/FactSheets/pdf/704/28_20220613152800_Albania2022_.pdf

¹⁰ <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2022/EIR2022-Global%20Trends.pdf>,

¹¹ <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/185663/1/v10-i2-p19-25-tourism-economic-growth.pdf>

¹² <https://pdfs.semanticscholar.org/7c7e/447cdd17ad268e6d27ff1de511fee7b9c9ba.pdf>

¹³ <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/117908/1/NDL2004-026.pdf>

ekonomike kur merren parasysh edhe faktor të tjerë të ndërlidhur.¹⁴ (Bahman Huseynli). Pra, rritje ekonomike edhe pse i atribuohet rritjes së Turizmit, në fakt vjen nga faktorë të tjerë që nuk lidhen me Turizmin. Në përputhje me gjetjet e disa studimeve të tjera, qëndrojnë edhe të dhënat në këtë raport. Përkatësisht ajo çfarë u tregua me lart në lidhje me kontributin në PBB të 1% të punonjësve, tregon që me rritjen e nivelit të të ardhurave kontributi i sektorit të shërbimeve (duke përfshirë jo vetëm turizmin) vjen në ulje. Duke marrë të ardhurat për frymë për të gjitha vendet e botës dhe gjithashtu edhe masën e kontributit në PBB të Turizmit, rezulton që lidhja midis këtyre variablave, korrelacioni është -0.057. Ky nivel korrelacioni na jep indicje që nuk kemi një lidhje të rëndësishme midis vendeve që kanë kontribut të lartë të Turizmit në PBB me nivelin e të ardhurave për frymë të qytetarëve. Madje lidhja është negative dhe e parëndësishme statistikisht.¹⁵

Nga ana tjetër, përveçse nuk kemi një siguri të plotë nëse Turizmi ndikon në rritjen ekonomike afatgjatë duhet të tregohet kujdes edhe me një sërë aspektesh negative që mund të ketë Turizmi jo vetëm në ekonomi, por edhe në fusha të tjera të jetës. Nga aspektet kryesore që përmenden si problematika të turizmit janë dëmtimet e ambientit që mund të përkthehen si në pasoja sociale-shëndetësore ashtu edhe në pasoja ekonomike, rritje të inflacionit që vjen nga rritja e kërkesës për para vendase, problemet me punësimin sezonal që përjashton mundësinë që qytetarët të kenë një punësim përgjatë gjithë vitit, por të jenë të varur plotësisht vetëm nga pjesa e turizmit. Këto aspekte mund të sjellin efete negative për vendasit lokalë. Gjithashtu, edhe në rastin kur ndikimi i turizmit është pozitiv në rritjen ekonomike duhet shikuar me kujdes se ku shkojnë të ardhurat, tek të huaj apo tek vendasit dhe se si është shpërndarja e tyre.

¹⁴ https://www.researchgate.net/profile/Bahman-Huseynli/publication/377664759_The_Effect_of_Tourism_Revenues_and_Inflation_on_Economic_Growth_in_Balkan_Countries/links/65b203ba9ce29c458bad533c/The-Effect-of-Tourism-Revenues-and-Inflation-on-Economic-Growth-in-Balkan-Countries.pdf

¹⁵ <https://data.worldbank.org/> të dhëna të marra nga Banka Botërore për 77 vende të botës dhe të analizuar nga autori.

Përfundime

- Pjesa më e madhe e popullsisë aktive, pra forcës punonjëse është angazhuar në Agrikulturë duke pasur produktivitet të ulët dhe kontribut mesatar në PBB. Përkatësisht rreth 35% e forcës së punonjësve është e punësuar në Agrikulturë, Pyje dhe Peshkim, ndërkohë që kontributi i këtij sektori në PBB është vetëm në masën 18.6%.
- Rreth 21% e Forcës Punonjëse është e punësuar në sektorin e industrisë dhe kontributi i këtij sektori në PBB është po aq, 21%. Krahasuar me vendet e tjera të botës, kontributi në PBB është më i ulët për 1% të punonjësve të angazhuar në këtë sektor.
- Në sektorin e shërbimeve merr pjesë pothuajse 44% e forcës punonjës, që përkthehet në 47% kontribut në PBB. Ky sektor tregon që ka vend për zhvillim të mëtejshëm dhe më shumë punonjës duhet të përfshihen në këtë sektor.
- Ekonomia shqiptare po krijon varësi nga sektori i ndërtimit dhe turizmit, ku të dy këta nënsektorë kanë një kontribut relativisht të lartë në ekonomi. Nëse heqim ndikim e ndërtimit dhe turizmit në rritjen ekonomike për tremujorin e katërt të vitit 2023, rezulton që rezultoni që rritja ekonomike do të ishte 1.96% dhe jo 3.8% sa ka rezultuar.
- Sektori i ndërtimit ka ndikim jo vetëm tek të PBB-ja dhe të ardhurat e shtetit, por gjithashtu edhe në të ardhurat e veta të vetë bashkive. Bashkitë me varësi më të lartë nga të ardhurat që vijnë nga ndërtimet e larta janë Himara, Kamza dhe Tirana. Të treja këto bashki mund të kenë ulje të të ardhurave të veta në rast të uljes së nivelit të ndërtimit në të ardhmen.
- Sektorët që Shqipëria nga të cilët varet ekonomia shqiptare për momentin (privat) siç është turizmi dhe ndërtimi kanë ndër nivelet më të ulëta të pagave, prandaj është mirë që të shikohet edhe ky aspekt në rastin kur bëhen planifikime për periudhën afatgjatë.
- Shqipëria në vitet e fundit ka pasur rritje të fluksit të turistëve (pozitive), por ndërkohë është rritur edhe varësia në PBB-në totale. Kontributi i Turizmit në Ekonominë Shqiptare për vitin 2021 është më i ulët vetëm se 13 vende në Botë, ku vetëm Mali i Zi ka nivel më të lartë kontributi se Shqipëria nga vendet e Europës. Kjo përpos indicjes pozitive të rritjes së sektorit të Turizmit tregon që sektorë të tjerë po ngelin të pazhvilluar duke krijuar varësi të lartë vetëm nga Turizmi.
- Përgjithësisht studime të ndryshme e shikojnë efektin e Turizmit në Ekonomi pozitiv, por ka studime të cilat e shikojnë me dyshim këtë efekt duke marrë parasysh edhe elementë të tjerë siç janë niveli i çmimeve, mjedisi, punësimi sezonal dhe jo përgjatë gjithë vitit etj.

Rekomandime

- Shqipëria duhet që të marrë masa për zhvillimin teknologjik të sektorit të Agrikulturës, Pyjeve dhe Peshkimit, duke u larguar nga prodhimi për konsum vetjak dhe duke iu afruar prodhimit për treg.
- Punonjësit në sektorin e Bujqësisë duhet të specializohen në sektorin e Shërbimeve duke kaluar në të ardhmen si forcë punonjëse në këtë sektor dhe duke i lënë vendin zhvillimit teknologjik në sektorin e Bujqësisë, Silvikulturës dhe Peshkimit.
- Sektori i Shërbimeve duhet të ketë fokus më të lartë nga Qeveria Shqiptare dhe jo të përfshihet vetëm Turizmi si pjesë e tij por më shumë teknologjia e Informacionit, që ka edhe vlerën më të lartë të shtuar dhe nivelin e pagave më të larta.
- Me kalimin e viteve ekonomia shqiptare duhet të krijojë baza të qëndrueshme në sektorë që sjellin zhvillim ekonomik afatgjatë dhe të mos rritet pesha e sektorit të Ndërtimit dhe Turizmit në ekonomi (si sektorë mund të rriten por krahas zhvillimit dhe rritjes së ndërthurur me sektorët e tjerë). Pra pesha kundrejt totalit të ekonomisë e këtyre dy nënsektorëve nuk duhet të jetë e lartë që ekonomia shqiptare mos të krijojë varësi.
- Turizmi duhet të orientohet drejt Turizmit të qëndrueshëm dhe të krijojë vende pune përgjatë gjithë vitit, duke sjellë në këtë mënyrë që ekonomia do të jetë më e shëndetshme dhe më e qëndrueshme.

Referenca

- Bahman Huseynli. (n.d.). Retrieved from https://www.researchgate.net/profile/Bahman-Huseynli/publication/377664759_The_Effect_of_Tourism_Revenues_and_Inflation_on_Economic_Growth_in_Balkan_Countries/links/65b203ba9ce29c458bad533c/The-Effect-of-Tourism-Revenues-and-Inflation-on-Economic-Growth-i
- Banka Botërore. (n.d.). Retrieved from <https://blogs.worldbank.org/en/europeandcentralasia/tourism-20-albania-new-opportunity-resilient-growth>
- Banka Botërore. (n.d.). Retrieved from <https://data.worldbank.org/>
- Chia-Lin Chang & Thanchanok Khamkaew & Michael McAleer. (n.d.). Retrieved from <https://repub.eur.nl/pub/17310/EI2009-40.pdf>
- Eugenio-Martín, Juan Luis; Morales, Noelia Martín; Scarpa, Riccardo. (n.d.). Retrieved from <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/117908/1/NDL2004-026.pdf>
- Financat Vendore. (n.d.). Retrieved from <http://financatvendore.al/data/revenues>
- Joaquim Ramos Silva & Carla Regina Ferreira Freire Guimarães . (n.d.). Retrieved from <https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1080/23322039.2017.1319606>
- Jonel Kristo. (n.d.). Retrieved from <https://pdfs.semanticscholar.org/7c7e/447cdd17ad268e6d27ff1de511fee7b9c9ba.pdf>
- Selimi, Nasir; Sadiku, Luljeta; Sadiku, Murat. (n.d.). Retrieved from <https://www.econstor.eu/bitstream/10419/185663/1/v10-i2-p19-25-tourism-economic-growth.pdf>
- WTTC. (n.d.). Retrieved from https://wttc.org/DesktopModules/MVC/FactSheets/pdf/704/28_20220613152800_Albania2022_.pdf
- WTTC. (n.d.). Retrieved from <https://wttc.org/Portals/0/Documents/Reports/2022/EIR2022-Global%20Trends.pdf>

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ELECTRONIC
DEBATE
SERVICES

EMPOWERING PUBLIC OPINION THROUGHOUT THE WORLD

www.qeverisja.qg.com.ci